



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1111/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Vlora Vuthaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 27.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i parashtruar nga Vlora Vuthaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër Raportit të kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 24.11.2017, ka pranuar apelin nga Vlora Vuthaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, me të cilën ka pretenduar se pas shpalljes së rezultateve zgjedhore nga KQZ-ja me numër rendor 09 ka fituar mandatin për anëtare në Kuvendin Komunal në Istog. Ka theksuar se, me datë 23.11.2017 KQZ-ja ka shpallur rezultatet dhe pas ankesave në PZAP ju është marrë mandati dhe i është bartur kandidates Mirushe Sadikaj me numër 06 nga lista e asambleisteve për subjektin politik PDK.

Nga të lartëcekurat i ka kërkuar KQZ-së që ta shqyrtoj apelin, pasi që e njëjta është e bazuar në argumente si në Formularët e Rezultateve për Kandidatë FRK të marra nga KQZ-ja, duke pretenduar lidhur me votat e manipuluar.

Për më tepër ka theksuar, në vendvotimin VV nr.0606C/01R me datë 22.11.2017 nga formularët e komisionerve, në cilësinë e kandidates me numër 09 më kanë dalur 11 vota, ndërsa kandidates Mirushe Sadikaj me numër 06 i kanë dalur 1 votë dhe pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja me datë 08.11.2017 thekson të ketë fituar gjithësej 97 vota. Ka theksuar se nga formularët e KQZ-së shkruhej në të

njëjtin vendvotim VV nr.0606C/01R mua më figurojnë 10 vota ndërsa kandidatës me numër 06 i figurojnë 0 vota. Ka thekuar se nuk kamë qenë e informuar ashtu si kandidatët e tjerë lidhur me procesin e rinumërimit të votave nga KQZ-ja, duke shtuar se në formularët e PZAP-it të datës 14.11.2017 në të njëjtin vendvotim VV nr. 0606C/01R më figurojnë 10 vota ndërkaq kandidatja me numër 10 i ka 1 vote . KQZ-së i ka kërkuar që në vendvotimin VV nr. 0606C/01R të rinumëroj dhe ti shiqoj procedurat e rinumërimit paraprak.

Në mbështetjeje të pretendimeve apelit i ka bashkangjitur Rezultatet Përfundimtare nga QNR-ja.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e apelit, gjeti se:

Apeli është i palejuar


Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Vlora Vuthaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog është i palejuar, sepse KQZ-ja ka shpallur Raportin e kandidatëve që kanë fituar mandatin pas rinumërimit me vendim të PZAP-së me datë 23.11.2017, ku nga ky rinumërim ka dal fituese Mirushe Sadikaj, nga radhët e subjektit politik PDK për Komunën e Istogut, ndërsa ka humbur mandatin parashtruesja e apelit Vlora Vuthaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik PDK .

Me dispozitën nenin 106.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Rezultatet Zgjedhore) i cili përcakton se: *“KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet e dala që u përkasin votimit dhe numërimit janë vendosur nga Komisioni Zgjedhor për Parashtrësit dhe Ankesat”*. Për më tepër nuk e përcakton asnjë dispozitë ligjore të parashtrohet ankesë ndaj rezultatit, që rezulton pas rinumërimit me vendimin e PZAP-it.

Prandaj, nga këto arsye të theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësit

ZL.Anr.1111/2017 me datën 27.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.